



Në drejtim të veprimit në përputhje me dispozitat e parashikuara ligjore të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 82/2008, 12/2009, 53/2011, 150/2015 dhe 190/2019), Qyteti i Shkupit publikon:

## **Shpallje për angazhimin e anëtarëve në Komisionin për avancimin e të drejtave të pacientëve**

### **Qëllimi i shpalljes:**

Në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, komunat dhe Qyteti i Shkupit janë të obliguara të formojnë Komision të përhershëm për avancimin e të drejtave të pacientëve, në përputhje me dispozitat nga fusha e qeverisjes vendore.

Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë, si vijon: dy përfaqësues të pacientëve – anëtarë të shoqatave së pacientëve, dy përfaqësues të organizatave joqeveritare që merren me të drejtat e njeriut dhe iniciativat civile, një përfaqësues nga shoqatat të cilat merren me të drejtat e grave, një përfaqësues nga shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, dy mjekë nga komunat dhe tre anëtarë të deleguar të Këshillit të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit.

Anëtarët e komisionit për avancimin e të drejtave të pacientëve nuk duhet të jenë të punësuar në institucionet shëndetësore në të cilat jepet mbrojtja shëndetësore.

Mandati i anëtarëve të komisionit është dy vjet, me të drejtë edhe të një zgjedhjeje të njëpasnjëshme.

Qyteti i Shkupit siguron përkrahje logjistike dhe mjete për punën e anëtarëve të komisionit.

Formimi i Komisionit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe përbërja e tij do të propozohen në seancën e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

### **Në shpallje mund të paraqiten:**

1. Organizata joqeveritare të pacientëve, organizata të cilat merren me të drejtat e njeriut dhe iniciativat civile, organizata të cilat merren me të drejtat e grave dhe organizata për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara të cilët duhet të emërojnë nga një përfaqësues për anëtar të komisionit.
2. Individë, mjekë ose profesione të tjera.

### **Detyrat e punës së anëtarëve të komisionit:**

- Pjesëmarrje e rregullt dhe aktive në takimet e komisionit;
- Përgatitja dhe realizimi i Planit të punës të komisionit me kornizë kohore;
- Përgatitja e Rregullores për punë të komisionit si dhe akte të tjera;
- Ndjekja dhe vlerësimi i gjendjes me mbrojtjen e të drejtave të pacientëve;

- Shqyrtimi i ankesave të pacientëve dhe propozimi i masave për përmirësimin e të drejtave të pacientëve deri te organet kompetente;
- Përgatitja dhe prezantimi i raportit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, para Këshillit të Qytetit të Shkupit,
- Përgatitja e informacioneve, materialeve të tjera promovuese me qëllim avancimin e të drejtave të pacientëve;
- Realizimi i aktiviteteve të tjera për avancimin e të drejtave të pacientëve dhe mbrojtja e tyre;

#### **Kritere të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët/et:**

- Të kenë të përfunduar arsimin sipëror (si përparësi do të konsiderohet përfundimi i studimeve në degën e mjekësisë, drejtësisë, punës sociale, por nuk përjashtohen edhe studimet tjera);
- Përvojë pune në fushën përkatëse ose në punën adekuate / sektori i veprimit: shëndetësi ose sektori juridik, shoqëri civile, demokratizim, të drejtat e njeriut, dialogu dhe diverziteti kulturor, shëndetësi, punë sociale – humanitare, nacionalitete, përfaqësimi dhe lobimi i pacientëve si dhe i personave tjerë të marginalizuar;
- Pjesëmarrja në projekte që çojnë në:
  - Avancimin e shëndetit dhe të drejtave të pacientëve;
  - Promovimin e mundësive të barabarta dhe avancimin e të drejtave të njeriut;
  - Zvogëlimin e stigmatizimit dhe diskriminimit të pacientëve;

#### **Dokumentacioni i nevojshëm për paraqitje**

##### **1. Organizatat e interesuara joqeveritare, duhet të dorëzojnë këto dokumente:**

- Formular me informacionet për organizatën;
- Letër nominimi nga organizata për emërim të një personi për anëtar të komisionit;
- CV (Biografi profesionale) e personit të nominuar dhe fotokopje nga diploma për arsimin e përfunduar;
- Dokumentacion tjetër me të cilin organizata joqeveritare konsideron se mbështet aplikimin dhe është në funksion të kriterëve të theksuara për zgjedhjen e anëtarit të komisionit.

##### **2. Individët e interesuar duhet të dorëzojnë këto dokumente:**

- CV (Biografi profesionale) dhe fotokopje nga diploma për arsimin e përfunduar;
- Letër për motivim;
- Dokumentacion tjetër me të cilin kandidati/ja konsideron se mbështet aplikimin dhe është në funksion të kriterëve të theksuara për zgjedhjen e anëtarit të komisionit.

Vlerësimi i propozimeve të arritura do të kryhet nga Komisioni për verifikim dhe çështje mandati, për mirënjohje, parashtrësia dhe ankesa, duke paraqitur propozimin pranë Këshillit të Qytetit të Shkupit.

#### **Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve**

Afati përfundimtar i dorëzimit të fletëparaqitjeve është deri më 27.10.2020, deri në orën 16:00.

Fletëparaqitjet së bashku me të gjithë dokumentacionin e skanuar dorëzohen përmes postës elektronike, në adresën: [pravanapacienti@skopje.gov.mk](mailto:pravanapacienti@skopje.gov.mk) (me shënim në lëndën – Fletëparaqitje për konkurs).

*Për informacione shtesë:*

Pyejtet për sqarime plotësuese mund të parashtrohen përmes mënyrës elektronike në [pravanapacienti@skopje.gov.mk](mailto:pravanapacienti@skopje.gov.mk) dhe në numrin e telefonit tel: 02/ 3297 321. Personi për kontakt Daniela Nakeva, bashkëpunëtor i lartë në Seksionin për mbrojtjen sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, Sektori për veprimtari publike, Qyteti i Shkupit.

**Qyteti i Shkupit**